

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura Shtetërore 2020

Lënda: Qytetari-Psikologji

Tiranë 2020

Qytetari

1. Kushtetuta është ligji themeltar i shtetit. Të gjitha ligjet e tjera duhet të jenë: **1 pikë**

- A) në kundërshtim me të.
- B) pjesërisht në përputhje me të.
- C) **plotësisht në përputhje me të.**
- D) pjesërisht në kundërshtim me të.

2. E drejta e ushtrimit të votës, lidhet me: **1 pikë**

- A) **të drejtat civile.**
- B) të drejtat sociale.
- C) të drejtat kulturore.
- D) të drejtat ekonomike.

3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: **1 pikë**

- A) krijon kushtet e duhura për forcimin e lidhjeve ekonomike mes vendeve anëtare.
- B) **siguron respektimin e zotimeve të ndërmarra nga Palët Kontraktuese të KEDNJ-së.**
- C) merret me përcaktimin e drejtimeve kryesore politike për integrimin Evropian.
- D) harton bazën legjislativë mbi të cilën funksionojnë Palët Kontraktuese të KEDNJ-së.

4. Gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2015, populli zgjodhi përfaqësuesit e tij. Në këtë rast është zbatuar parimi i: **1 pikë**

- A) barazisë.
- B) së drejtës.
- C) kushtetutshmërisë.
- D) **sovrانيتit.**

5. E drejta për shëndet është e lidhur me të drejta të tjera si: e drejta për ushqim, strehim, mjedis të shëndetshëm etj., prandaj ajo është një e drejtë: **1 pikë**

- A) veçuese.
- B) **përfshirëse.**
- C) përjashtuese.
- D) përzgjedhëse.

6. Ndarja dhe balancimi i pushteteve është karakteristikë dalluese për sistemin e: **1 pikë**

- A) **republikës.**
- B) mbretërisë.
- C) despotizmit.
- D) totalitarizmit.

7. Një ndër funksionet kryesore të shkollës është socializimi, i cili përcaktohet si proces: **1 pikë**

- A) që nxit zhvillimin e aftësive krijuese.
- B) **ndërveprimi me të tjerët gjatë gjithë jetës.**
- C) i përgatitjes së nxënësve për tregun e punës.
- D) i mësimi dhe zbatimit të rregullave në shkollë.

8. Cila prej alternativave të mëposhtme përbën një funksion të reklamës? **1 pikë**

- A) Ankimimi në rast pakënaqësie ndaj një produkti apo shërbimi.
- B) Krahasimi mes firmave që ofrojnë të njëjtat produkte apo shërbime.
- C) Rezervimi i një produkti apo shërbimi të dëshiruar përmes reklamës.
- D) **Informimi i publikut rreth një produkti apo shërbimi të caktuar.**

9. Tabela me forma të ndryshme, të vendosura në anë të rrugës ose mbi të dhe që shërbejnë për të gjithë përdoruesit e saj, janë pjesë e sinjaleve rrugore: **1 pikë**

- A) **vertikale.**
- B) horizontale.
- C) të ndritshme.
- D) të policëve të trafikut.

10. Mjeti më modern i informimit është: **1 pikë**

- A) radioja.
- B) gazeta.
- C) **interneti.**
- D) televizioni.

11. Mësuesja e qytetarisë u dha nxënësve një detyrë me temë: 'Mbrojtja e mjedisit'. Për realizimin e saj, nxënësit e klasës u ndanë në grupe pune, ku gjithsecili kishte detyra specifike dhe në fund i gjithë grupi duhet të prezantonte punën e bërë. Kjo teknikë, që përdori mësuesja, lidhet më së shumti me: **1 pikë**

- A) zhvillimin e talenteve.
- B) **funksionin socializues të shkollës.**
- C) transmetimin e normave kulturore.
- D) përgatitjen e nxënësve për tregun e punës.

12. "Liria sindikale mbrohet me ligj".
Ky fragment është shkëputur nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, në pjesën ku përcaktohen: **1 pikë**

- A) detyrat e punëdhënësit.
- B) detyrat e punëmarrësit.
- C) të drejtat e punëmarrësit.**
- D) të drejtat e punëdhënësit.

13. Ana dhe Beni kanë një kontratë bashkëpunimi mes tyre. Ata patën një mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kontratës dhe iu drejtuan gjykatës për zgjidhjen e problemit. Trupi gjykues pasi dëgjoi të dy palët mori vendimin për zgjidhjen e kontratës mes Benit dhe Anës. Kjo situatë, ka të bëjë me funksionin e ligjit si: **1 pikë**

- A) mjet që ruan rendin në shoqëri.
- B) mjet për zgjidhjen e konflikteve.**
- C) mjet që sjell ndryshime shoqërore.
- D) rregullator i marrëdhënieve sociale.

14. Grupimi i ligjeve që përcaktojnë veprimet e ndaluara dhe dënimet që i shoqërojnë ato, përbën: **1 pikë**

- A) Kodin Civil.
- B) Kodin e Punës.
- C) Kodin Penal.**
- D) Kodin e Familjes.

15. Në kategorinë e të drejtave ekonomike e sociale bën pjesë: **1 pikë**

- A) e drejta për kujdes shëndetësor.**
- B) e drejta e pjesëmarrjes në qeverisje.
- C) e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
- D) e drejta për mbrojtje dhe trajtim të barabartë para ligjit.

16. Sinjalet që kanë formë trekëndëshi, me kulm lart, me kornizë të kuqe, sfond të bardhë ose të verdhë dhe me simbol të zi janë sinjale: **1 pikë**

- A) të rrezikut.**
- B) urdhëruese.
- C) horizontale.
- D) të ndritshme.

17. Shërbimi shëndetësor dytësor i referohet: **1 pikë**

- A) programeve depistuese që synojnë kurimin e sëmundjes.
- B) spitaleve dhe ka për qëllim marrjen e masave për zbulimin e sëmundjes.**
- C) qendrave shëndetësore dhe ka qëllim shmangien e zhvillimit të sëmundjes.
- D) spitaleve universitare duke realizuar ndërhyrje për të ndaluar progresin e sëmundjes.

18. Cila prej alternativave të mëposhtme është tërësisht një përgjegjësi e konsumatorit? **1 pikë**

- A) Siguria për mallin që blen.
- B) Mbrojtja e interesave makroekonomikë.
- C) Ruajtja e kontratës së shërbimit të marrë.**
- D) Ankimimi dhe shpërbliimi për dëmin e shkaktuar.

19. Mjeti i komunikimit që ka ndikuar më shumë në jetën e anëtarëve të shoqërisë është: **1 pikë**

- A) radioja.
- B) revista.
- C) gazeta.
- D) televizioni.**

20. Pasuritë kulturore të vendit tonë si qyteti i Gjirokastrës apo Beratit janë tashmë pasuri botërore. Legjislati në mbrojtje të këtyre pasurive, lidhet me vlerat: **1 pikë**

- A) morale të ligjit.
- B) sociale të ligjit.
- C) politike të ligjit.
- D) ekonomike të ligjit.**

21. Pushtetet në Shqipëri janë të pavarura, ndërveprojnë me njëri – tjetrin, por ato edhe konfliktohen për realizimin e disa qëllimeve të caktuara. Këto konflikte zgjidhen nga: **1 pikë**

- A) Gjykata e Lartë.
- B) Gjykata Kushtetuese.**
- C) Gjykata e Shkallës së Dytë.
- D) Gjykata e Shkallës së Parë.

22. Në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut shkruhet:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Ky fragment lidhet me: **1 pikë**

A) ndalimin e diskriminimit.

- B) të drejtën për liri dhe siguri.
- C) ndalimin e shpërdorimit të të drejtave.
- D) të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

23. Të drejtat që mbrojnë lirinë e individit nga shtrëngimet e qeverive, organizatave apo individëve, përfaqësojnë të drejtat: **1 pikë**

A) civile dhe politike.

- B) ekonomike dhe sociale.
- C) për zhvillim dhe mjedis.
- D) shoqërore dhe kulturore.

24. Kledia ishte sëmure. Prindërit e shoqëruan pranë qendrës shëndetësore të zonës së tyre të banimit me qëllim shmangien e zhvillimit të mëtejshëm të sëmundjes. Kledia mori shërbim të nivelit:

1 pikë

A) parësor.

- B) dytësor.
- C) terciar.
- D) universitar.

25. “Ne nuk e trashëgojmë tokën nga paraardhësit tanë, ne e kemi marrë atë hua nga fëmijët tanë”. Kjo shprehje, në diskutimet për çështjet e mjedisit, lidhet më shumë me parimin e:

1 pikë

- A) kujdesit.
- B) parandalimit.
- C) përgjegjësisë ligjore.
- D) zhvillimit të qëndrueshëm.**

26. Kërkesa për një produkt cilësor dhe pa defekte, është:

1 pikë

- A) një obligim i konsumatorit.
- B) një detyrim i konsumatorit.
- C) një e drejtë e konsumatorit.**
- D) një përgjegjësi e konsumatorit.

27. Denisa zbriti për të luajtur në oborrin e pallatit dhe pa një zotëri të linte një qese me mbeturina. Ajo iu drejtua zotërisë dhe i tha që mbeturinat nuk mund të hidhen aty. Zotëria kërkoi falje dhe e mori qesen. Problemet që shqetësojnë një komunitet mund të parandalohen nëse çdo individ:

1 pikë

A) respekton të drejtat dhe detyrimet e jetesës në bashkëpronësi.

- B) respekton të drejtat por jo detyrimet e jetesës në bashkëpronësi.
- C) respekton detyrimet por jo të drejtat e jetesës në bashkëpronësi.
- D) nuk respekton as të drejtat as detyrimet e jetesës në bashkëpronësi.

28. Ada ndodhej në një kryqëzim pranë vijave të bardha. Semafori tregonte ngjyrën e kuqe për këmbësorët, ndërkohë polici që ndodhej në mes të kryqëzimit i bëri me shenjë që të kalonte rrugën. Cili sinjal rrugor ka përparësi në këtë rast?

1 pikë

- A) Sinjali vertikal.
- B) Sinjali horizontal.
- C) Sinjali i ndritshëm.
- D) Sinjali i policit të trafikut.**

29. Mjetet e informimit publik janë të shumta. Ato klasifikohen në tradicionale dhe të reja. Mjeti i parë tradicional i komunikimit është: **1 pikë**

- A) filmi.
- B) radioja.
- C) gazeta.**
- D) televizioni.

30. Nga programet e bashkisë për mbështetjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit, përfitojnë ato Asamble Bashkëpronarësh, që:

1 pikë

- A) kanë paguar plotësisht taksën e pasurisë së paluajtshme.**
- B) kanë paguar pjesërisht taksën për pasurinë e paluajtshme.
- C) kërkojnë përshtatjen e hyrjeve të shkallëve për banorë të caktuar.
- D) kërkojnë ribërjen e fasadës sepse banorëve nuk u pëlqen ajo aktuale.

Psikologji

31. Konfliktet dhe frustracioni janë burimet kryesore të:

1 pikë

- A) stresit.
- B) dashurisë.
- C) skizofrenisë.
- D) konformizmit.

32. Energjia dhe instinktet me të cilat lindim përbëjnë:

1 pikë

- A) idin.
- B) egon.
- C) mbiegon.
- D) superegon.

33. Cila nga dukuritë e mëposhtme përfaqëson një gjendje të ndryshuar të ndërgjegjes?

1 pikë

- A) Gjumi
- B) Leximi
- C) Komunikimi
- D) Rikujtimi

34. Në të mësuarin me kushtëzim klasik, ngacmuesi i pakushtëzuar shkakton një:

1 pikë

- A) reagim të kushtëzuar.
- B) refleks të pakushtëzuar.
- C) reagim të pakushtëzuar.
- D) ngacmues të pakushtëzuar.

35. Psikologët që ndihmojnë njerëzit të zgjidhin problemet e tyre personale dhe janë të specializuar në diagnostikimin dhe trajtimin e çrregullimeve mendore, sjellore dhe emocionale i përkasin nënfushës së psikologjisë:

1 pikë

- A) klinike.
- B) shkollore.
- C) kulturore.
- D) eksperimentale.

36. Procesi me anën e të cilit pasqyrojmë në vetëdijen tonë format e plota të sendeve, objekteve apo dukurive, quhet:

1 pikë

- A) ndijim.
- B) emocion.
- C) perceptim.
- D) motivacion.

37. Ana e vogël 3 vjeçare po përpqej të kapte kukullën e saj mbi raftin e bibliotekës. Në një moment ajo kthehet nga prindërit e saj të cilët po e vëzhgonin. Kur pa se ata i buzëqeshën, ajo vazhdoi të përpqej derisa e kapi kukullën. Sipas psikologut Erikson, Ana është në stadin e:

1 pikë

- A) iniciativës ose fajit.
- B) zellit ose inferioritetit.
- C) autonomisë ose turpfit.
- D) besimit ose mosbesimit.

38. Në zhvillimin e fëmijës para lindjes, ndikojnë negativisht:

1 pikë

- A) ilaçet.
- B) shëtitjet.
- C) të qeshurat.
- D) përkëdheljet.

39. Kur fëmija fillon të kryejë veprime matematikore si mbledhja, zbritja, shumëzimi etj., sipas Piazhesë, është në stadin:

1 pikë

- A) sensomotor.
- B) paraoperacional.
- C) operacional formal.
- D) konkret operacional.

40. Teoria humaniste e personalitetit thekson se:

1 pikë

- A) individi ka natyrë të mirë e pozitive.
- B) individi ka disa detyra madhore në jetë.
- C) personaliteti përbëhet nga tre struktura.
- D) bota e trashëguar gjendet tek ne që në lindje.

41. Nëse jemi duke fjetur dhe zgjohemi nga zhurma më e vogël, atëherë jemi në:

1 pikë

- A) gjumin me LSHS.
- B) etapën I të gjumit me LJSHS.
- C) etapën III të gjumit me LJSHS.
- D) etapën II të gjumit me LJSHS.

42. Pjesa e neuronit, e cila merr informacionet nga neuronet e tjera quhet:

1 pikë

- A) akson.
- B) dendrit.
- C) mielina.
- D) degëzime fundore.

43. Të mësuarit që mbështetet në proceset njohëse është: **1 pikë**

- A) të mësuarit përmes përvojës.
- B) të mësuarit përmes kushtëzimit klasik.
- C) të mësuarit përmes kushtëzimit veprues.
- D) të mësuarit përmes proceseve kognitive.**

44. Duke shkuar në punë, Ina kaloi pranë shkollës ku kishte mësuar shkronjat e para. Në mendje i erdhën fytyrat e qeshura të shokëve dhe shoqeve të klasës. Këto kujtime ruhen në kujtesën:

1 pikë

- A) shqisore.
- B) afatgjatë.**
- C) afatshkurtër.
- D) emocionale.

45. Mësuesja u dha nxënësve dhjetë fjalë të cilat duhet t'i mbanin mend. Ajo i ndihmoi ata duke u thënë që t'i klasifikonin fjalët sipas kategorive logjike. Cila teknikë e të mbajturit mend është sugjeruar në këtë rast nga mësuesja? **1 pikë**

- A) Teknika e fjalëve lidhëse.
- B) Copëtimi i informacionit.**
- C) Teknika e shkronjave të para.
- D) Lidhja e informacionit me vende të caktuara.

46. Depresioni është një problem mjaft shqetësues në ditët e sotme. Përmes studimeve të ndryshme, psikologët kanë përcaktuar shkaqet e sjelljes depresive duke përbushur kështu një nga synimet e psikologjisë që lidhet me: **1 pikë**

- A) kontrollin e sjelljes.
- B) shpjegimin e sjelljes.**
- C) përshkrimin e sjelljes.
- D) parashikimin e sjelljes.

47. Humbja e aftësive të të mbajturit mend dhe të riprodhimit të kujtimeve për ngjarjet para se të shfaqet amnezia, janë pjesë e: **1 pikë**

- A) hiperamnezisë.
- B) paramnezisë.
- C) amnezisë retrograde.**
- D) amnezisë anterograde.

48. Prindërit e regjistruan Erën në një shkollë tjetër afër banesës së tyre, por ajo ka shumë vështirësi në përshtatjen me mjedisin e ri. Për këtë problem, ata duhet t'i drejtohen një psikologu: **1 pikë**

- A) klinik.
- B) mjedisi.
- C) edukimi.
- D) shkollor.**

49. Iliri nuk shoqërohet shumë shpesh me shokët e klasës. Ai është i ndrojtur dhe i mbyllur në vetvete. Iliri i përket tipit të personalitetit:

1 pikë

- A) kolerik.
- B) sanguin.
- C) flegmatik.
- D) melankolik.**

50. Mësuesja e ngriti Mirin në mësim dhe u habit nga përgjigjet e tij të sakta. Ai asnjëherë nuk e ngre dorën kur mësuesja pyet në klasë. Të mësuarit e nxënësit përmes proceseve kognitive quhet:

1 pikë

- A) latent.**
- B) i thjeshtë.
- C) zbulues.
- D) mekanik.

51. Gjëndra tiroide si një nga gjëndrat me sekrecion të brendshëm prodhon hormonin: **1 pikë**

- A) insulinë.
- B) tiroksinë.**
- C) epinefrinë.
- D) estrogjen.

52. Një nga teoritë e shpjegimit të sjelljes dhe personalitetit është teoria humaniste. Kjo teori e shpjegon personalitetin bazuar tek: **1 pikë**

- A) faktorët e pavetëdijshëm.
- B) ndikimi i kushteve të mjedisit të jashtëm.
- C) ndikimi i faktorëve të jashtëm dhe brendshëm njëkohësisht.
- D) pjesa e ndërjegjishme e qenies njerëzore dhe liria për të vepruar.**

53. Zhvillimi mendor i fëmijëve sipas Piazhësë kalon në disa stadi. Sipas tij, gjatë stadiit operacional konkret fëmijët janë të aftë: **1 pikë**

- A) të përdorin skema logjike.
- B) të zgjidhin probleme abstrakte.
- C) të përdorin skema që përfshijnë trupin dhe ndijimet.
- D) të përdorin imazhe ose simbole mendore për të kuptuar.

54. Mirelës, po i shkëlqenin sytë dhe po fluturonte nga gëzimi, sepse mori notën 10 në testin e matematikës. Cili prej përbërësve të emocionit është shfaqur në këtë rast? **1 pikë**

- A) Përbërësi sjellor.
- B) Përbërësi kognitiv.
- C) Ndjenja subjektive.
- D) Nxitshmëria fiziologjike.

55. Beni kujtoi me nostalgji ditën kur erdhi në jetë vëllai i tij i vogël. Ky informacion është ruajtur në kujtesën: **1 pikë**

- A) shqisore.
- B) episodike.
- C) semantike.
- D) procedurale.

56. Ndijimi është procesi i shndërrimit të ngacmuesve shqisor në impulse nervore. Organi më i madh ndijor i trupit tonë është: **1 pikë**

- A) syri.
- B) veshi.
- C) hunda.
- D) lëkura.

57. Cila nga veprimtaritë e mëposhtme çon në një gjendje të ndryshuar të ndërgjegjes së individit? **1 pikë**

- A) Të luajturit futboll.
- B) Dëgjimi i mësimit.
- C) Meditimi në natyrë.
- D) Recitimi i një vjershe.

58. Hormoni insulinë gjendet në gjëndrën e: **1 pikë**

- A) tiroides.
- B) hipofizës.
- C) pankreasit.
- D) mbiveshkores.

59. Sipas psikologëve, nëse dikush zemërohet apo inatohet menjëherë, ai i përket temperamentit të tipit: **1 pikë**

- A) kolerik.
- B) sanguin.
- C) flegmatik.
- D) melankolik.

60. Jona ndihet e stresuar sepse pas kontrollit që bëri tek mjeku zbuloi se vuan nga një sëmundje. Stresi në këtë rast shkaktohet nga ky burim: **1 pikë**

- A) presioni.
- B) konflikti.
- C) ndryshimi jetësor.
- D) shqetësimi i përditshëm.